

UNMIK/REG/2005/53
20 dhjetor 2005

RREGULLORE NR. 2005/53

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2001/19
MBI DEGËN E EKZEKUTIVIT TË INSTITUCIONEVE TË PËRKOHSHME
TË VETËQEVERISJES NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Duke vepruar në pajtim me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Pas shpalljes së Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001, mbi themelimin e degës së ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë dhe Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/5 të datës 4 mars 2002 dhe Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/15 të datës 16 mars 2005 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19,

Në konsultim me Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës,

Me qëllim të ndryshimit të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, në mënyrë që të mundësojë themelimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të përcaktojë përgjegjësitë dhe funksionet e këtyre ministrive të reja,

Duke ditur pushtetin suprem të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm dhe autorizimet e përgjegjësitë tjera të rezervuara për të sipas Kapitullit 8 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Duke rikonfirmuar dispozitat me të cilat rregullohet puna e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë të përcaktuara në Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/6 të datës 15 shkurt 2000 mbi emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve,

prokurorëve ndërkombëtarë dhe në Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/64 të datës 15 dhjetor 2000 mbi caktimin e gjyqtarëve-prokurorëve ndërkombëtarë dhe (ose) ndërrimin e vendit ku zhvillohet gjykimi,

Me anë të kësaj Rregulloreje shpall si vijon:

Neni 1 Ndryshimi

Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, Rregullorja e ndryshuar e UNMIK-ut nr. 2001/19 sërish ndryshohet si vijon:

- (a) Në nenin 2.2 shtohen dy nënnene (n) dhe (o) si vijon:
 - (n) Ministria e Drejtësisë (Shtojca XV);
 - (o) Ministria e Punëve të Brendshme (Shtojca XVI);
- (b) Shtojcat e reja XV dhe XVI do të përcaktohen në shtojcat I dhe II, bashkëngjitur kësaj Rregulloreje dhe
- (c) Si rrjedhojë e themelimit të ministrive të reja dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që do të themelohet me një rregullore të veçantë, aneksi IX që ka të bëjë me Ministrinë e Shërbimeve Publike, zëvendësohet me shtojcën IX të përcaktuar në shtojcën III, e cila i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje.

Neni 2 Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 3 Shqyrtimi i punës së përkohshme

Të paktën tre muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm bën një shqyrtim të punës fillestare gjatë kësaj periudhe të përkohshme të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme. Pas rezultatit pozitiv të shqyrtimit të tillë, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm u cakton përgjegjësi të tjera Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, të cilat pasqyrohen në Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/19.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi me 20 dhjetor 2005.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Dokumenti i bashkëngjitur nr. IShtojca XV
Ministria e Drejtësisë

Ministria:

- (i) Zhvillon politikën brenda fushës së saj të përgjegjësisë, mundëson përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e drejtësisë, përfshirë edhe prokurorinë publike. Kjo nuk përfshin çështjet që kanë të bëjnë me administrimin e gjyqësisë dhe gjykatave;
- (ii) Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, menaxhon çështjet administrative, financiare dhe buxhetore të Ministrisë dhe zhvillimin e rregullave administrative, teknike dhe financiare dhe rregullave me të cilat përcaktohet puna e personelit ndihmës dhe burimet materiale për të siguruar funksionim efikas të sistemit të prokurorisë pa kufizuar, penguar ose ndërhyrë në asnjë mënyrë në veprimet e Prokurorisë Publike dhe në zbatimin e hetimeve penale;
- (iii) Siguron udhëzime për zhvillimin dhe zbatimin e politikave prokuroriale në Prokurorinë Publike të Kosovës, që nuk kufizojnë, pengojnë ose ndërhyjnë në asnjë mënyrë në veprimet e Prokurorisë Publike dhe në zbatimin e hetimeve penale;
- (iv) Ofron aftësimin, përfshirë aftësimin profesional dhe të prokurorëve në bashkëpunim me Institutin Gjyqësor të Kosovës;
- (v) Organizon provime për kualifikimin e prokurorëve, të avokatëve (përfshirë përfaqësuesit ligjorë) dhe për profesionistët tjerë ligjorë përmes Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe organeve të tjera profesionale të pavarura;
- (vi) Siguron bashkërendimin e çështjeve që kanë të bëjnë me shërbimin korrektues;
- (vii) Bashkëpunon me organizatat përkatëse në lidhje me mbikëqyrjen e pavarur të sistemit të prokurorisë dhe shërbimit korrektues;
- (viii) Siguron informacione dhe statistika mbi shërbimin korrektues dhe sistemin e prokurorisë;
- (ix) Siguron mbrojtjen e të dhënave personale që kanë të bëjnë me shërbimin korrektues dhe sistemin e prokurorisë;

- (x) Siguron bashkëpunimin në çështjet lidhur me shërbimin korrektues me entitetet përkatëse brenda Kosovës;
- (xi) Ndiemon në punësimin, trajnimin dhe në vlerësimin e personelit për shërbimin korrektues;
- (xii) Zhvillon dhe zbaton politikën për sigurimin e qasjes së drejtë dhe efikase të pjesëtarëve të të gjitha bashkësive në sistemin e drejtësisë;
- (xiii) U ofron ndihmë viktimave të krimit, dhe në veçanti viktimave të dhunës në familje, trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbikëqyrë zyrën e koordinuesit për ndihmë të viktimave siç parashihet në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/4;
- (xiv) Sipas nevojës ndihmon UNMIK-un në ushtrimin e përgjegjësisë së tij për bashkëpunimin ligjor ndërkombëtar, duke përfshirë bashkëpunimin me Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut me Gjykatën Penale Ndërkombëtare dhe Tribunalin Ndërkombëtar të krimeve në ish-Jugosllavi;
- (xv) Përfaqëson Qeverinë në konteste dhe procedura gjyqësore dhe tribunale të arbitrazhit;
- (xvi) Ofron mbështetje me ekspertë në përgatitjen e marrëveshjeve të Qeverisë në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, që ato të arrihen në përputhshmëri me Kornizën Kushtetuese;
- (xvii) Kryen çdo detyrë tjetër që i caktohet Ministrisë me ligj.

Dokumenti i bashkëngjitur nr. II

*Shtojca XVI*Ministria e Punëve të Brendshme

Ministria:

- (i) Harton politikën brenda fushës së përgjegjësi të saj, ndihmon përgatitjen e legjislacionit dhe zbatimin e tij në fushën e rendit dhe sigurisë publike;
- (ii) Administron çështjet financiare dhe buxhetore të Shërbimit Policor të Kosovës dhe të Ministrisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë;
- (iii) Në bashkërenditje me UNMIK-un është përgjegjëse për zbatimin e menaxhimit të integruar kufitar në lidhje me rregullimin e vendkalimeve të vendosura kufitare, në pajtim me standardet e vendosura nga Bashkimi Evropian, dhe në veçanti për një bashkërenditje efektive në mes të policisë dhe autoriteteve të tjera publike të përfshira në kontrollin e kalimit të kufirit;
- (iv) Zbaton Ligjin në fuqi mbi lëvizjen e personave brenda dhe jashtë Kosovës dhe, në bashkërenditje me UNHCR-në, ndihmon në shqyrtimin e kërkesave për status refugjati në pajtim me ligjin në fuqi;
- (v) Duke vepruar përmes UNMIK-ut, bashkëpunon me shërbimet e jashtme, me agjencitë dhe me organizatat ndërkombëtare, të cilat kanë përgjegjësi në fushën e rendit dhe sigurisë publike;
- (vi) Kryen funksione në procedurat disiplinore kundër policëve në pajtueshmëri me ligjin në fuqi dhe me Komisionin e Policisë për Emërime të Larta dhe Disiplinë (KPELD);
- (vii) Zhvillon dhe zbaton strategjinë e marrëdhënieve publike të Ministrisë dhe të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë dhe organeve të tjera publike me përgjegjësi në fushën e rendit dhe sigurisë publike;

- (viii) Ndhmon në administrimin dhe në mirëmbajtjen e regjistrimit qendror civil dhe bazës së të dhënave;
- (ix) Ndhmon në administrimin e politikës që lidhet me dokumente civile dhe ushtron përgjegjësinë për regjistrimin e automjeteve;
- (x) Mbledh, mirëmban dhe analizon të dhënat statistikore dhe informatat në fushën e rendit dhe të sigurisë publike;
- (xi) Kryen funksione që lidhen me gatishmërinë emergjente sipas paragrafit 5.5 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme;
- (xii) Kryen funksione të tjera që i caktohen Ministrisë sipas ligjit.

Dokumenti i bashkëngjitur nr. III

*Shtojca IX*Ministria e Shërbimeve Publike

Ministria:

- (i) Zhvillon dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave për një shërbim civil shumetnik, të paanshëm, profesional dhe të përgjegjshëm;
- (ii) Zhvillon dhe bashkërendon zbatimin e politikave për aftësimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të shërbimit civil;
- (iii) Administron listën e pagave dhe sistemin e pagesave të shërbimit civil;
- (iv) Ofron shërbime menaxhuese të inxhinierisë dhe të ndërtimit për institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes;
- (v) Zhvillon standardet për shërbimet e teknologjisë informative që do të përdoren nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes dhe bashkërendon ofrimin e shërbimeve të teknologjisë informative për institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes;
- (vi) Zhvillon dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave për ofrimin e shërbimeve të prokurimit në pajtim me rregullat dhe procedurat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
- (vii) Ndhmon në administrimin e politikave që lidhen me regjistrimin e OJQ-ve;
- (viii) Mbikëqyrë mbledhjen, mirëmbajtjen, analizën dhe publikimin e statistikave zyrtare.

